


INSTITUTI EPIK

MAJ 2019

AGJENDA EVROPIANE E REFORMAVE (ERA)



PËRMBLEDHJE EKZEKUTVIE



Në nëntor 2016, u lansua Agjenda Evropiane e Reformave (ERA) nga Kryeministri i Kosovës, dhe Komisioneri për politikat e fqinjësisë evropiane dhe negociatave për Zgjerim i BE-së.

Qëllimi i Agjendës Evropiane të Reformave është që të përzgjidhen prioritetet kyçe të MSA-së me qëllim të avancimit të perspektives Evropiane të Kosovës dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Në nëntor 2016, ishin identifikuar gjithsej 22 prioritet që është dashur të përmbushen deri në fund të vitit 2017. Prioritetet ishin bazuar në 3 shtylla kyçe: (1) sundimi i ligjit, qeverisja e mirë (2) konkurrueshmëria, mjedisi biznesor, si dhe (3) arsimit dhe punësimi.

Dy vite e gjysmë pas lansimit të ERA-s, në bazë të vlerësimit të Institutit EPIK institucionet nuk kanë arritur të zbatojnë pjesën dërrmuese të prioritetëve që dalin nga Agjenda Evropiane e Reformave. Kjo përkundër faktit se të gjitha 22 prioritetet është dashur të përmbushen deri nëntor 2018.

**Nga gjithsej 22 prioritetet,
vetëm 5 prioritetet janë
përmbushur plotësisht**

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE



Sipas vlerësimit të Institutit EPIK, nga gjithsej 22 prioritete, vetëm 5 prioritete janë përmbushur plotësisht. Ndërsa, në të gjitha 17 prioritete të tjera ka pasur progres, mirëpo asnjë nga to nuk është përmbushur në tërësi.

Pesë prioritetet e përmbushura plotësisht janë:

(1) Miratimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; (2) Miratimi i 3 ligjeve themelore për reformën e administratës publike; (3) Lansimi i prokurimit elektronik; (4) Zbatimi i Strategjisë dhe Planit Veprimit për luftimin e ekonomisë joformale; dhe (5) Përmirësimi i prodhimit të statistikave zyrtare, nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Ndërsa nga ana tjetër, është shënuar regres i theksuar në ndërtimin e institucioneve publike të pavarura dhe profesionale. Sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përkundër rritjes së numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale dhe rritjes së numrit të rasteve të shënjestruara, institucionet nuk kanë arritur të përfundojnë më sukses asnjë rast të profilit të lartë të korrupsionit.

Është shënuar regres i theksuar në ndërtimin e institucioneve publike të pavarura dhe profesionale


PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në rrafshin ekonomik, rritja ekonomike nuk u përktheu në krijimin e vendeve të punës. Kosova ka përjetuar rritje më të madhe të çmimeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Rritja e çmimeve është udhëhequr nga çmimet e ushqimit nga muaji korrik dhe ka arritur 5.5% në dhjetor 2018 (Banka Botërore).

Investimet e Huaja Direkte kanë shënuar rënie nga 2.9% në 2016, në 2.8% në 2018 (Banka Botërore). Papunësia e përgjithshme është rrit për 2.1%, nga 27.5% në vitin 2016 në 29.6% në 2018. Papunësia e të rinjve është rrit për 3%, nga 52.4% në 2016, në 55.4% në 2018. Ndërsa, papunësia e grave është rrit për 1.6%, nga 31.8% në 2016, në 33.4% në 2018 (ASK).

Investimet e Huaja Direkte kanë shënuar rënie, ndërsa papunësia e përgjithshme është rrit

NIVELI I ZBATIMIT



SHTYLLA 1: QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT

Përkundër miratimit të Kodit Penal, institucionet nuk kanë arritur të miratojnë edhe Kodin e Procedurës Penale për të siguruar pezullimin/largimin e zyrtarëve publik të akuzuar/dënuar për korrupsion. Institucionet nuk kanë marr masa për të siguruar transparencën e financimit të partive politike. Po ashtu, ka vazhduar politizimi në emërimet e larta në institucionet publike, duke përfshirë institucionet e pavarura, bordet e ndërmarrjeve publike dhe agjencitë rregullatorë. Institucionet nuk kanë treguar vullnet që të ndërmarrin një reformë gjithëpërfshirëse të administratës publike.

Sa i përket rritjes së numrit të gjyqtarëve në Departamentin Administrativ dhe Departamentin Ekonomik të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara në çështjet administrative dhe ekonomike, gjatë vitit 2017 Gjykata Themelore në Prishtinë ka zgjidhur më pak raste se sa ka pranuar në punë.

Në kuadër shtyllës I, institucionet kanë arritur të përmbushin në tërësi këto 3 prioritete:

- (1) Miratimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
- (2) Miratimi i 3 ligjeve themelore për reformën e administratës publike
- (3) Lansimi i prokurimit elektronik

SHTYLLA 1: QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT



Departamenti administrativ dhe ekonomik ka shënuar trend negativ në zgjedhjen e lëndëve krahasuar më vitin 2016. Gjatë vitit 2018, janë rekrutuar gjyqtarë shtesë në Departamentin Administrativ dhe Departamentin Ekonomik. Efekti i rritjes së numrit të gjyqtarëve mbetet të vlerësohet në vitin 2019 (Instituti i Kosovës për Drejtësi).

Sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përkundër rritjes së numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale dhe rritjes së numrit të rasteve të shënjestruara, institucionet nuk kanë arritur të përfundojnë më sukses asnjë rast të profilit të lartë të korrupsionit.

institucionet nuk kanë arritur të përfundojnë më sukses asnjë rast të profilit të lartë të korrupsionit

SHTYLLA 1: QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT

NUMRI I RASTEVE TË PROFILIT TË LARTË TË
PËRFUNDUARA ME AKTGJYKIM DËNUES TË FORMËS SË
PRERË PËR KORRUPSION

2016

0

2019

0

SHTYLLA II: KONKURRUESHMËRIA DHE KLIMA E INVESTIMEVE

Sipas Raporti të fundit të Rregullt Ekonomik të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, rritja ekonomike në vitin 2018 ishte solide në 4.2%. Investimet publike dhe private kontribuan me 5.7%, për dallim nga 1.5% në vitin 2017.

Investimet private vazhduan të rriten, përmes kreditimit më të lartë të investimeve dhe pjesërisht nga një përmirësim i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në gjysmën e dytë të vitit. Investimet publike po ashtu shënuan përmirësim, të mbështetura nga të ardhurat e procesit të privatizimit.

Konsumi kontribuoi në rritje ekonomike me 2%, duke u bazuar në pagat më të larta publike, remitancat dhe kreditimin e konsumatorit.

Eksportet neto shënuan rënie 3.5% nga rritja reale e Bruto Produktit Vendor (BPV); importet shënuan rritje për të plotësuar kërkesën për mallra kapitale.

Në kuadër shtyllës II, institucionet kanë arritur të përmbushin në tërësi këto 2 prioritete:

- (1) Zbatimi i Strategjisë dhe Planit Veprimit për luftimin e ekonomisë joformale
- (2) Përmirësimi i prodhimit të statistikave zyrtare, nga Agjencia e Statistikave të Kosovës

SHTYLLA II: KONKURRUESHMËRIA DHE KLIMA E INVESTIMEVE



Rritja ekonomike nuk u përktheu në krijimin e vendeve të punës. Rritja e numrit të të punësuarve gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018 nuk ka arritur të kompensojë humbjet e vendeve të punës në gjysmën e parë të vitit. Shkalla e punësimit ka rënë për 1% në 2018 dhe shkalla e punësimit në 28.8% mbetet e ulët.

Kosova ka përfjetuar rritje më të madhe të çmimeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Rritja e çmimeve është udhëhequr nga rritja e çmimeve të ushqimit nga muaji korrik dhe ka arritur 5.5% në dhjetor 2018.

Investimet e Huaja Direkte kanë shënuar rënie nga 2.9% në 2016, në 2.8% në 2018. Ndërsa, në vlerësimin 2019 të Bankës Botërore për të Bërit Biznes, Kosova ka shënuar regres nga vendi 40 në vendin 44.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni i çmimeve të konsumit u rrit nga 0.3% në 2016, në 1.1% në vitin 2018.

Rritja ekonomike nuk u përktheu në krijimin e vendeve të punës

Investimet e Huaja Direkte kanë shënuar rënie nga 2.9% në 2016, në 2.8% në 2018

SHTYLLA III: PUNËSIMI DHE ARSIMI

Përkundër miratimit të strategjisë punësimit, planit të veprimit për të rinjtë dhe zbatimit të ligjit për agjencinë e punësimit, Kosova ka shënuar regres edhe në pothuaj të gjithë indikatorë të papunësisë.

Papunësia e përgjithshme është rrit për 2.1%, nga 27.5% në vitin 2016 në 29.6% në 2018. Papunësia e të rinjve është rrit për 3%, nga 52.4% në 2016, në 55.4% në 2018. Ndërsa, papunësia e grave është rrit për 1.6%, nga 31.8% në 2016, në 33.4% në 2018 (ASK).

Asnjë nga prioritetet e arsimit nuk është përmbushur në tërësi.

Në kuadër shtyllës III, institucionet kanë ndërmarr një numër masave, por të cilat fatkeqësisht nuk kanë arritur të kontribuojnë në përmbushjen e prioritetëve të synuara

Papunësia e përgjithshme është rrit për 2.1%, nga 27.5% në vitin 2016 në 29.6% në 2018

PA PU NË SIA

29.6%

2018

27.5%

2016

INSTITUTI I KOSOVËS PËR POLITIKAT EVROPIANE, 2019.
TE GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.

